V E N D I M
Nr. 215, datë 16.5.2002

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NEGOCIATOR SHQIPTAR PËR PËRGATITJEN E NEGOCIATAVE ME KOMISIONIN EUROPIAN, *KOMUNITETET EUROPIANE* DHE SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT

(Ndryshuar me VKM nr. 627, datë 13.12.2002; nr. 387, date 12.6.2003)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 29 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002" me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për ngritjen e grupit negociator shqiptar për përgatitjen e negociatave me Komisionin Europian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

2. Shfuqizuar.

3. Anëtarët e grupit negociator shqiptar janë përgjegjës për ndjekjen dhe bashkërendimin e detyrave specifike, sektoriale, si dhe për këshillimin e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, përkatëse, për realizimin e negociatave për marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Komisionin Europian, komunitetet europiane dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

4. Ministri i Shtetit për Integrimin, në cilësinë e kryenegociatorit, nëpërmjet Departamentit të Integrimit në Këshillin e Ministrave, bashkërendon punën e institucioneve përgjegjëse për realizimin e detyrimeve, në kuadër të hapjes së negociatave dhe të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Komisionin Europian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

5. Anëtarët e grupit negociator, si përfaqësues të institucioneve përkatëse, përgatisin raporte e dokumente standarde dhe kontribuojnë në hartimin dhe projektimin e strategjive, të planeve dhe të projekteve për procesin e integrimit europian, në bashkëpunim dhe bashkërendim me Departamentin e Integrimit, pranë Ministrit të Shtetit për Integrimin.

6. *Anëtarët e grupit negociator t'i paraqesin drejtuesit të institucionit përkatës nevojat për burime, njerëzore dhe logjistike, për ndjekjen dhe plotësimin detyrave, të ngarkuara në kuadër të integrimit europian.*

7.Anëtarëve të grupit negociator shqiptar t'u jepet një shpërblim deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, sipas përcaktimit të Ministrit të Shtetit për Integrimin, pasi të jetë bërë vlerësimi i veprimtarisë së tyre. Ky fond të përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për Këshillin e Ministrave.

8. Anëtarët e gurpit negociator emërohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko